



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal

Mbledhja nr. 5

Prishtinë, me 01 qershor 2021, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Doarsa Kica – Xhelili, Mergim Lushtaku, Fidan Jilta, Valon Ramadani, Nijazi Isaku, Fitim Haziri, Besim Muzaqi, Floretë Zejnullahu, Agim Veliu, Besnik Tahiri, Igor Simiq.

Në mbledhje morën pjesë: Eshref Shabani, kryetar i KPMSHCK-së, Arben Mehmeti, Malsore Gashi-Bajraktari, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, Sali Zyba, deputet dhe BIRN.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Doarsa Kica -Xhelili, kryetare e komisionit, me këtë:

Rend të ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 25.05.2021;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, për vitin 2020;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua, me një ndryshim, pika 2 e rendit të ditës shtyhet për mbledhjen e radhës.

- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, për vitin 2020;**

Doarsa Kica-Xhelili, kryetarja e komisionit, njoftoi komisionin se shqyrtimi i raportit të

KPMSHCK-së është përcaktuar në bazë të Ligjit 06/L-048, nenit 28 për punën 1 vjeçare, pikërisht për vitin 2020. Gjithashtu, njoftoi të pranishmit se komisioni shqyrton performancën e KPMSHCK-së dhe në këtë kontekst i propozoi anëtarëve të këshillit që të prezantojnë edhe për sfidat në administratën publike dhe fjalën ia kaloi kryetarit të KPMSHCK-së,

Eshref Shabani, njoftoi komisionin se, KPMSHCK-ja gjatë vitit 2020 nuk ka pasur kuorum për vendimmarrje andaj raporti është më tepër informues që përmban detaje për aktivitetet e këshillit, numrin e ankesave, numrin e ankesave të pazgjidhura të vitit 2018-2019.

Nga tetori i vitit të kaluar, kur është emëruar këshilli, brenda funksionit të vet ka formuar kolegjet për zgjidhjen e lëndëve të pazgjidhura ndërsa për ato lëndë të cilat kanë qenë para skadimit të afatit për shqyrtim dhe zgjidhje, në afat prej 45 ditësh këshilli ka vendosur që konform dispozitave në fuqi për ato lëndë të zgjatë afatin për shqyrtimin e tyre edhe për 10 ditë të tjera shtesë. Sfidë e këshillit ka qenë skadimi i afatit prej 45 ditësh për vendimmarrje për lëndët të cilave iu ka kaluar afati, e numri total i lëndëve me afat të skaduar është gjithsejt 444.

Kryetarja e Komisionit, pyeti, në bazë të cilës dispozitë të ligjit në fuqi, këshilli ka vendosur për zgjatjen e afatit të lëndëve për shqyrtim?

Eshref Shabani, zgjatja e afatit të tyre është bërë nga konsultat që këshilli ka marrë nga gjykatat, në takimet e organizuara me gjykatat, se si të veprohet me lëndët që iu ka skaduar afati dhe me ato të cilat kanë qenë pranë skadimit të afati. Këshilli gjithashtu ka shqyrtuar edhe lëndët të cilat gjykatat i kanë kthyer KPMSHCK-së për rivendosje.

Sa i përket sfidave në administratën publike ato regjistrohen gjatë procedurës së monitorimit të institucioneve, mirëpo meqë këshilli ka qenë pa kuorum ka qenë e pamundur që të monitorohet procesi në fjalë, për më tepër me pezullimin e disa neneve të ligjit për KPMSHCK, nga gjykata kushtetuese, është shkaktuar një konfuzitet sa i përket procesit të monitorimit dhe rekrutimit.

Besim Muzaqi, pyeti: si keni mundur të nxirrni 3 vendime komplet të ndryshme, sipas raportit, në nëntor të vitit 2020, KPMSHCK ka marrë vendim për zgjidhjen e lëndëve që ju ka skaduar afati, në janar këshilli ka marrë vendim për pezullimin e lëndëve të cilave ju ka skaduar afati, ndërsa në muajin shkurt përsëri këshilli ka marrë vendim për zgjidhjen e lëndëve të cilave ju ka skaduar afati.

- Si janë paguar zyrtarët shtesë kur është e ditur se në kohë pandemie nuk ka pasur angazhime dhe të gjitha institucionet kanë punuar me staf të reduktuar?

- Gjithnjë sipas raportit, tek pika 10 dhe 11 e faqës 29, këshilli nuk ka mundur të ushtrojë asnjë aktivitet, pastaj është theksuar se këshilli ka realizuar të gjitha aktivitetet me sukses, lidhur me këtë cili është realiteti?

Eshref Shabani, u përgjigj, lidhur me përzgjedhjen e lëndëve duhet të dallohet pezullimi, nga vendosja, ndërsa sa i përket pagesës së zyrtarëve janë të lejuara shtesat për arsye se këshilli ka një numër me të ngushtë të zyrtarëve, janë vetëm 23.

Sa i përket realizimit të aktiviteteve në raport me janë të përshkruara se aktivitetet janë realizuar me sukses nga 30 tetori 2020, pas marrjes së mandatit të anëtarëve të këshillit.

Besim Muzaqi, u deklarua se nuk ka marrë përgjigje për pyetjen lidhur me vendimet e nxjerra që janë në kundërshtim njëra me tjetrën.

Mergim Lushtaku, pyeti, sipas raportit nga 94 vendime të nxjerra 3 nga to janë zbatuar, lidhur me këtë ai pyeti cilat janë ato institucione që nuk kanë zbatuar vendimet duke aluduar në Ministrinë e MTI. Gjithashtu, pyeti lidhur me shkarkimin e zyrtarëve nga Qeveria Kurti I, të cilat janë konsideruar të paligjshme.

Eshref Shabani, u përgjigj, nuk ka asnjë vendim të pazbatuar, ato që janë të shënuara në raport, pas datës 30 mars 2021, kur ne kemi proceduar raportin për Kuvend edhe ato janë zbatuar. Ndërsa, lidhur me shkarkimin e zyrtarëve nuk ka pas asnjë ankesë në këshill, ato të cilat janë dorëzuar më vonë janë konsideruar si të paafatshme dhe nuk janë pranuar nga këshilli.

Mergim Lushtaku, kërkoi nga këshilli që në webfaqe të këshillit të publikohet dhe raporti për vitin 2019 të cilën komisioni parlamentar nuk e kishte shqyrtuar për arsye se i njëjti ishte proceduar në Kuvend i panëshkruar.

Kryetarja e Komisionit, kërkoi nga anëtarët e KMP SHCK-së që të mos fokusohen në arsyetimet se raporti mund të jetë i mangët për arsye se këshilli ka qenë pa kuorum duke konsistuar se 2 anëtarët e këshillit, të cilët janë rizgjedhur në tetor të vitit 2020, kanë qenë anëtarë të këshillit dhe kanë vazhduar mandatin me riemërim nga Kuvendi.

Besnik Tahiri, pyeti, cilat janë veprimet që këshilli ka ndërmarrë për ndryshimin e rregulloreve konform ligjit për zyrtarët publik dhe cili është plani i këshillit lidhur me këtë?

- Mbi bazën e faktit se këshilli funksionon në mënyrë të pavarur, si monitorohen të gjitha institucionet?

Ai propozoi, që mandati i anëtarëve të këshillit prej 7 vite është i papranueshëm dhe duhet të ndryshohet.

Eshref Shabani, u përgjigj, ndryshimi i rregulloreve dhe harmonizimi i tyre me ligjin do të bëhet brenda 2 javëve të ardhshme, ndërsa sa i përket ligjit për zyrtarët publik, ligji nuk afekton në këshillin, sepse këshilli zbaton ligjin për procedurën e përgjithshme administrative.

Nijazi Isaku, pyeti lidhur me shumat e larta të shpenzimeve brenda 3 mujorit, përfshirë edhe ato të udhëtimit të cilat janë të paarsyeshme në kohë pandemie.

Ai gjithashtu, kërkoi informacione për zbatimin e vendimeve për vitet 2018-2020.

Eshref Shabani, u përgjigj, të gjitha shpenzimet janë të miratuara nga sekretari dhe sipas raportit të auditorit nuk ka pasur tejkalime.

Sa i përket zbatimit të vendimeve disa lëndë janë bartë nga viti në vit, ndërsa që raporti përfshinë punën e këshillit vetëm për vitin 2020.

Floreta Zejnullahu, pyeti lidhur me pikën 7.7 të raportit tek ndarja e ankesave dhe rishqyrtimi i ankesave.

Eshref Shabani, u përgjigj, nuk ka ankesë kur pala pajtohet me vendimin.

Fitim Haziri, pyeti, si janë radhitur për procedim lëndët e bartura nga vitet e mëhershme dhe si është vendosur për trajtimin e tyre, a ka pasur lëndë më të vjetra për shqyrtim në kohën kur këshilli ka vendosur të shqyrtojë ankesën e drejtorit të MTI.

Eshref Shabani, u përgjigj, sipas rregullit lëndët radhiten sipas radhës, por meqë ato përgatiten nga sekretari, ka pasur raste kur nuk janë proceduar sipas radhës, ndërsa sa i përket ankesës së drejtorit të MTI-së ka qenë ankesë e vitit 2019 dhe është trajtuar si lëndë e radhës.

Kryetarja e Komisionit, pyeti, a mund të konfirmoni se nuk ka pasur lëndë në pritje për vendosje në kohën kur këshilli ka vendosur për ankesën e sipërpërmendur? Cilat janë masat që këshilli ndërmer në rast të moszbatimit të vendimeve?

Eshref Shabani, u përgjigj, në rastet kur punëdhënësi nuk e zbaton vendimin e këshillit zbatohet dispozita e ligjit lidhur me ndërprerjen e pagës për 50% të punëdhënësit dhe për këtë njoftohet Kuvendi dhe Kryeministri.

Salih Zyba, kërkoi sqarime nga kryetari i KPMSHCK-së lidhur me mospërputhshmërinë në numrin e nëpunësve, sipas raportit me numrin e paraparë në organogram dhe duke cituar raportimet e kryetarit të këshillit se KPMSHCK është i vetmi organ administrativ që marrin vendime brenda afateve të parapara, ndërsa në debat po diskutohet për joafate.

Eshref Shabani, u përgjigj, të dhënat për moszbatim të vendimeve janë të cekura në faqen 26 të raportit, ndërsa për çështjet e pezullimit të lëndëve nuk është caktuar afat, sepse këshilli ka qenë i pasigurt juridikisht dhe kjo ka qenë arsyeja e pezullimit.

Agim Veliu, pyeti lidhur me harmonizimin e rregulloreve me ligjet dhe rekomandoi që të gjitha lëndët e pazgjidhura të zgjidhen në mënyrë që të shmangen pasojat për shërbyesit civil.

Valon Ramadani, tha se, nga raportimi i anëtarëve të KPMSHCK-së kuptohet qartë se institucioni më së paku është i pavarur, për arsye se të gjithë anëtarët prezent të cilët kanë marrë mandatin 7 vjeçar nga Kuvendi, në intervistat e tyre para komisionit të Kuvendit janë deklaruar se do ta respektojnë ligjin dhe pavarësinë institucionale të këshillit.

Kthimi në vend të punës, i një zyrtari të nivelit drejtues të MTI-së, i cili është gjykuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare nga këshilli është cenim i pavarësisë së institucionit dhe për këtë ai pyeti: a ka qenë këshilli i ndikuar nga qarqet politike në kryerjen e funksionit dhe vendimmarrjen për ankesa dhe a konsideroheni përgjegjës se keni shkelur nenin 12 të ligjit për KPMSHCK-në?

Eshref Shabani, u përgjigj, për rastin në fjalë në cilësinë e kryetarit të kolegjit asnjëherë nuk kam qenë i ngarkuar dhe vendimi për shkarkimin e zyrtarit në fjalë është nxjerrë nga një sekretar i cili ka qenë jo kompetent, duke konsistuar se i njëjti sekretar ka qenë i shkarkuar pa procedurë disiplinore.

Në kuptim të respektimit maksimalisht të ligjit, ai tha: po qe se ju më konfirmoni vetëm një rast që unë kam shkelur qoftë edhe vetëm një dispozitë ligjore, unë jap dorëheqje.

Kryetarja e Komisionit, pyeti, pse nuk janë të publikuara të gjitha raportet?

- për mungesën e monitorimit sipas faqes 33 pika 15.2 të raportit?
- cilin ligj është duke e zbatuar këshilli?
- kërkoi sqarime për pjesën e raportit, faqe 30.

Eshref Shabani, u përgjigj, se të gjitha raportet e këshillit janë të publikuara, sa i përket monitorimit në institucione në vitin 2020, këshilli nuk ka pasur monitorim të institucioneve për arsye të pandemisë dhe volumit të lëndëve që ka pasur për shqyrtim, KPMSHCK zbaton ligjin për zyrtarët publik duke përjashtuar institucionet e pavarura kushtetuese deri në masën nuk ku cenohet pavarësia e tyre.

Kryetarja e Komisionit, kërkoi nga anëtarët e komisionit që të votojnë për apo kundër miratimit të raportit.

Konstatim: Komisioni me 6 vota “Kundër”, votoi kundër miratimit të raportit dhe nxori këtë:

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, në bazë të nenit 67 dhe 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 01.06.2021, shqyrtoi Raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2020 dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqet këtë,

R e k o m a n d i m

1. Të mos miratohet Raporti vjetor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2020.
2. Arsyetimin e raportit me rekomandime e paraqet deputetja, Doarsa Kica-Xhelili, kryetare e komisionit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 28 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ia paraqet raportin vjetor të punës Kuvendit të Kosovës.

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, në mbledhjen e mbajtur më 01.06.2021, shqyrtoi Raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2020, dhe vlerësoi se i njëjti nuk i përmbush obligimet ligjore për raportim dhe Kuvendit i rekomandon mos miratimin e tij.

4. Të ndryshme.

Komisioni diskutoi lidhur me kërkesën e deputetës së komisionit nga radhët e komunitetit turk e cila kërkoi që të zgjidhet sa më shpejtë çështja e përkthyesëve në gjuhën turke.

Mbledhja përfundoi në orën 13:20.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit

Kryetare e komisionit,

Doarsa Kica Xhelili